

## Kategoria 1/ Apolonia-Albetrol 2-1

nga AlbaniaSoccer  
E diel, 20 Tetor 2013 17:59

---



Ndeshja e zhvilluar te dielen pasdite ne stadiumin "Roza Haxhiu" te qytetit te Lushnjes, midis Apolonise - Albetrol, plotesoi ndeshjet e javes se shtate te kampionatit te kategorise se pare. Ndeshja midis tyre ka perfunduar me fitoren e skuadres fierake me rezultatin e ngushte 2-1. Fillimisht ka qene, debutiesit e Albetrol me ane te Gjokes ne te 34' qe kane kaluar ne avantazh, fale nje finalizimi te sakte brenda zones. Nje minute para perfundmit te pjeses se pare Ambruze per Apolonine barazoi shifrat. I njeiti autor, ne te 75' shenoi dhe golin e dyte dhe te fitores per skuadren e Apolonise. Ne pergjithesi ndeshja ka qene e barabarte, me raste te pastra per shenim nga te dy skuadrat. Dhe pse ndeshje derbi, nuk pati shume sportdashes. Reth 200 vete dhe keto kryesisht lushnjar kane qene te pranishem ne shkallet e stadiumit te qytetit te Lushnjes. Me kete fitore skuadra e Apolonise eshte pozicionuar e dyta ne renditje me 17 pike te barabarta me Elbasanin, e cila ne saje te golverazhit me te mire mban poziten e pare te rendetjes. Te shtunen e ardheshme me 26 Tetor do te zhvillohen ndeshjet e javes se 8-te.

Apolonia - Albetrol 2-1

Shenues: Gjoka 34', ambruze 44, 75'